



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:136952

Datë: 10.03.2025

Numri i dokumentit: 06960324

A.nr.1687/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Valbona Gjonbalaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Nikolla, në konfliktin administrativ të paditësve, L.R., M.F., B.H., Rr.M., B.B., Sh.B., A.D., E.B. dhe B.C. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati H.S. me adresë në rrugën “F.A.” ...kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) me seli në Prishtinë, me bazë juridike: “anulim vendimi”, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të palëve ndërgjyqëse me datë 10.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **I.APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësve, L.R., M.F., B.H., Rr.M., B.B., Sh.B., A.D., E.B. dhe B.C. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati H.S. me adresë në rrugën “F.A.”, me të cilën kanë kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.365/2022 i datës 10.06.2022.
- II. **ANULOHET** vendimi A.nr.365/2022 i datës 10.06.2022 me numër të protokollit 3386/2022 i datës 10.06.2022 i të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështja i kthehet të njëjtit në rishqyrtim dhe rivendosje
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në prani të paditësit B.B. dhe përfaqësuesit të paditësve avokatit H.S. dhe në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur KPMSHCK - Avdyl Bekteshi me autorizim.

Paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre me padinë e datës 05.07.2022, kanë kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve dhe të anulohet vendimi me numër A.nr.365/2022 me numër protokollit 3386/2022 i datës 10.06.2022 i KPMSHCK-së, si dhe vendimet me numër ref.152/2022 i datës 15.03.2022, vendimi me numër reference 149/2020 dhe

nr. Protokollit 875 i datës 16.03.2022, vendimi i datës 15.03.2022 me numër reference 144/2022, vendimi me numër reference 148/2022 i datës 15.03.2022, vendimi numër reference 153/2022 i datës 15.03.2022, vendimi numër reference 150/2022 dhe nr. Protokollit 871 i datës 16.03.2022, vendimi numër reference 146/2022 i datës 15.03.2022 dhe vendimi numër reference 145/2022 i datës 15.03.2022 të nxerrura nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ashtu që të mbeten në fuqi vendimet me numër reference 1060/12 i datës 13.11.2012 në lidhje me emërimin e L.R. anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe vendimi nr.133/2020 i datës 01.09.2020 dhe Akt emërimi AE nr.08/2021 i datës 19.02.2021 në lidhje me sistemimin e përhershëm të L.R. në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Shërbime Konsullore në Departamentin e Çështjeve Konsullore, të mbetet në fuqi vendimi me numër reference 242/13 i datës 10.05.2013 në lidhje me emërimin e M.F. Anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe vendimi nr.122/2020 i datës 01.09.2020 dhe Akt emërimi AE nr.11/2021 i datës 19.02.2021 në lidhje me emërimin e M.F. në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Shërbime Konsullore në Departamentin e Çështjeve Konsullore, të mbetet në fuqi vendimi me numër reference 193/14 i datës 08.04.2014 në lidhje me emërimin e B.H. Anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe vendimi nr.124/2020 i datës 01.09.2020 në lidhje me sistemimin e përhershëm të B.H. në Pozitën e Zyrtares së Lartë për Privilegje dhe Imunitete në Departamentin e Protokollit të Shtetit, të mbetet në fuqi vendimi me numër reference 725/2012 i datës 26.07.2012 në lidhje me emërimin e Rr.M. Anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe vendimi nr.134/2020 i datës 01.09.2021 për sistemimin e përhershëm të Rr.M. në pozitën e Zyrtarit për Çështje Sigurie në Divizionin për IT dhe Shërbime Logjistike dhe Akt emërimi Nr.18/2021 në lidhje me të njëjtën pozitë, të mbetet në fuqi vendimi me numër reference 1061/12 i datës 13.11.2012 në lidhje me emërimin e B.B. Anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe vendimi nr.136/2020 i datës 01.09.2020 në lidhje me sistemimin e përkohshëm të B.B. në pozitën e Zyrtarit të Lartë të Pasurisë në Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, në kuadër të Ministrisë së Jashtme dhe Diasporës, të mbetet në fuqi vendimi me numër reference 095/2014 i datës 19.02.2014 në lidhje me emërimin e Sh.B. Anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe vendimi nr.114/2020 i datës 01.09.2020 dhe Akt emërimi AE nr.29/2021 i datës 15.06.2021 në lidhje me sistemimin e përhershëm të Sh.B. në pozitën e Zyrtares së Lartë për Parlamentin Europian dhe Europë Lindore në Departamentin për Evropë dhe BE, të mbetet në fuqi vendimi me numër reference 1064/12 i datës 13.11.2012 në lidhje me emërimin e A.D. Anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe vendimi nr.111/2020 i datës 01.09.2021 dhe Akt emërimi në lidhje me sistemimin e përhershëm të A.D. në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Politika të OSBE-së në Departamentin për Nato dhe Politika të Sigurisë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të mbetet në fuqi vendimi me numër reference 421/14 i datës 28.05.2014 në lidhje me emërimin e E.B. Anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe vendimi nr.15/2021 i datës 01.02.2021 në lidhje me sistemimin e përhershëm të E. B. në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Politika të Sigurisë në Departamentin për NATO dhe Politika të Sigurisë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe të mbetet në fuqi vendimi

me numër reference 1059/12 i datës 13.11.2012 në lidhje me emërimin e B. C. Anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe vendimi nr.116/2020 i datës 01.09.2020 në lidhje me sistemimin e përkohshëm të B. C. në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Këshillin European/Europën Jugore në Departamentin për Europë dhe BE në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe gjithashtu të obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që nga data 15.03.2022 e deri në zbatimin e këtij aktgjykimi ti bëjë paditësve kompensimin e pagave, shtesave dhe beneficioneve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, bazuar në Vendimet dhe Akt emërimet e fundit të tyre.

Përfaqësuesi i paditësve në seancat gjyqësore ka deklaruar se, në cilësinë e përfaqësuesit të 9 paditësve të cilët kanë parashtruar padi, konsideron se vendimi i të paditurit A.nr.365/2022 i datës 10.06.2022 është një vendim i ligjshëm për arsye se jo kompetenca e shpallur në raport me trajtimin e ankesave të paditësve është në kundërshtim me vet mandatin kushtetues dhe ligjor të paditurës, e cila ka për mandat dhe funksion që të shqyrtoj ankesat e nëpunësve civil, status të cilin e kanë pasur edhe paditësit në rastin e emërimit në Shërbimin Diplomatik të Kosovës, për arsye se, Ligji i Shërbimit Civil i cili ka qenë në fuqi në kohën e emërimit të këtyre paditësve në pozitat e tyre ua ka njohur statusin e veçantë diplomatëve të emëruar në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ky status ka njohur veçantinë e procedurave të emërimit të anëtarëve të Shërbimit Diplomatik, mbi bazën e të cilit edhe Ligji i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimi Diplomatik në nenin 7 par.5 dhe nenin 8 par. 1 ka përcaktuar në mënyrë taksative që emërimi i personelit në ambasadë ose misione bëhet në përputhje me Ligjin i cili rregullon Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore të Ministrisë, mbi bazën e të cilës dispozitë ligjore Ministria e Punëve të Jashtme kishte nxjerrë aktin nënligjor, gjegjësisht Rregulloren 2/2009 për Emërimin e Anëtarëve të Shërbimit Diplomatik, e për të cilën rregullore në mënyrë krejtësisht të veçantë është rregulluar e gjithë procedura e rekrutimit të kësaj kategorie duke përjashtuar Rregulloren 02/2010 për Rekrutimin e Shërbyesve Civil e cila ka derivuar nga LSHC. Pra, thekson se emërimi i paditësve është bërë mbi bazën e Rregullores me nr.02/2009 dhe nga shkresat e lëndës që posedojnë paditësit, rezulton se ky rekrutim është kryer në përputhje të plotë me këtë akt të veçantë. Po ashtu, neni 8 par.1 e përcakton që personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij legjislacioni përkatës i cili është në fuqi. Të njëjtin koncept e kanë edhe dispozitat e Ligjit që ka qenë atëherë në fuqi të Ligjit për Shërbimin Civil. Thekson se, anëtarët e Shërbimit Diplomatik në momentin e pranimit të vendimit për emërim pas përfundimit të procedurave mbi bazën e legjislacionit, e fitojnë me automatizëm edhe statusin e nëpunësit civil dhe nga kjo rrjedh se trajtimi i shkeljeve nga marrëdhënia e punës do të duhej të bëhej nga e paditura si organ i shkallës së dytë, e që për mendimin tonë vendimi për jo kompetencë i të paditurës përveç që është në kundërshtim me mandatin e tyre kushtetues dhe ligjor është edhe në kundërshtim me dispozitat e lartcekura. Për më tepër, si ka mundësi që e paditura ta shpallë veten jo kompetent për trajtimin e ankesave kur për çdo vit monitoron misionet që kanë vetëm staf diplomatik, e që në kuptim logjik rezulton se, ose kanë qenë jo kompetent për ti monitoruar misionet diplomatike ose nëse janë kompetent nuk mund ta zbatojnë kompetencën e tyre në funksionin e monitorimit e mos ta zbatojnë funksionin e shqyrtimit të ankesave, pasi që janë të njëjtit persona që kanë statusin e njëjtë sikurse janë në mision edhe në

ministri, kjo mbi bazën e parimit “ një shërbim një ministri” andaj kjo sa i përket çështjes së kompetencës. Vendimi i të paditurës kur konstaton se ankuesit në rastin konkret paditësit nuk kanë ofruar dëshmi se është përfunduar procedura sipas Rregullores 02/2009 dhe as ministria nuk ka ofruar, konsideron se paligjshmëria e këtij vendimi qëndron te kjo pikë për shkak se nga shkresat e lëndës shihet qartazi se paditësit kanë ofruar dëshmi më shumë sesa organi punëdhënës. Në vend që të kërkojë përgjegjësi nga Ministria e Punëve të Jashtme e cila është përgjegjëse për mbikëqyrje dhe zhvillimin e procedurave, e paditura e gjuan barrën e provës tek paditësit për mos ofrim të dëshmive. MPJ nga i gjithë materiali i procedurës së rekrutimit të paditësve ka dërguar vetëm 3 dokumente dhe atë; vendimi i Ministrit mbi shpalljen e konkursit, Shpallja e konkursit në gazetën publikë dhe Listën e ngushtë të kandidatëve aplikues, asnjë dokument tjetër. Ndërkohë që paditësit kanë ofruar dëshmi deri tek ftesa për mbajtjen e testit të gjuhëve, njoftimi se kanë kalu apo s’kanë kalu ftesat për testin me shkrim, si dhe njoftimin apo ftesën për intervistën me gojë. Në pyetje të gjykatës se, se padia është e parashtruar vetëm ndaj të paditurit KPMSHCK, përfaqësuesi i paditësve ka deklaruar se, padia është e hartuar mbi bazën e nenit 46 par. 34 të LKA-së e cila i mundëson gjykatës që në rastet kur e sheh se ka bazë për vendimmarrje ta vendosë çështjen në merita e sidomos kur kemi të bëjmë me një procedurë e cila mund të stërgjartet vetëm me anulimin e vendimit të paditurës. Andaj, konsideron se padia e parashtruar nga ana e tij është hartuar në mënyrë të rregullt dhe janë trajtuar edhe vendimet e Ministrisë. E gjithë kjo është që lënda të trajtohet meritorisht nga gjykata. Edhe sikur të ishin vendimet e paligjshme Ministria shfuqizimin e atyre vendimeve e ka nxjerrë në kundërshtim me nenin 58 par.2 të LPPA-së e cila përcakton që anulimi apo shfuqizimi mund të bëhet më së largu brenda një afati prej 5 vitesh nga dita e nxjerrjes së atij vendimi, e që në rastin e paditësve të gjitha vendimet janë nxjerrë pas më shumë se 5 vite, andaj vendimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme janë bërë në kundërshtim me dispozitën e cekur, ku një gjë të tillë e ka konfirmuar edhe një anëtar i kolegjit vendimmarrës i cili ka dhënë mendimin mospajtues lidhur me këtë çështje, ku ka konstatuar se vendimet e MPJ-së janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 05/L 035 të LPPA-së neni 58 par.2. Po ashtu, Ministria ka tejkalluar kompetencat e saj që ia jep ligji ku në pikën 2 të dispozitivve të vendimeve të marra përveç anulimit të vendimit të Ministrit ka anuluar edhe akt emërimet dhe vendimet e nxjerra nga Sekretari i Përgjithshëm të cilat janë lëshuar me rastin e kthimit të këtyre diplomatëve në Ministri. Humbja e statusit të anëtarit të shërbimit diplomatik është e rregulluar në mënyrë taksative edhe me nenin 25 të Ligjit për Shërbimet e Jashtme. I njëjti sa i përket provave të paraqitura nga përfaqësuesi i të paditurës në seancën gjyqësore ka deklaruar se, ai aktgjykim nuk është i formës së prerë dhe gjykata nuk është e obligueshme që ta trajtojë aktgjykimin si provë, sepse nuk e dimë se cilat prova janë trajtuar në atë aktgjykim, kurse sa i përket aktgjykimit tjetër e ka njoftuar gjykatën se është vendos në gjykatë të Apelit dhe nuk ka të bëjë me çështjen e njëjtë të rekrutimit, por ka të bëjë me çështjen e pagës, që do të thotë se nuk është objekt i njëjtë i kontestit dhe e ka kundërshtuar si provë. I njëjti ka theksuar se, duke pasur parasysh se në petitumin e padisë është kërkuar edhe kthimi në vendin e punës dhe kompensimi i pagave dhe beneficioneve të tjera retroaktive i ka propozuar gjykatës që të nxjerrë provat me ekspertizë financiare duke llogaritur pagat për secilin paditës. I njëjti ka deklaruar se, sa i përket ekspertizës të cilën e ka pranuar nuk ka vërejtje por vetëm pyetje për ekspertin financiar. Ai gjithashtu ka kundërshtuar deklaratimet e përfaqësuesit të paditurit lidhur me paraqitjen si provë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, sepse nuk ka të bëjë me çështjen e njëjtë. Për ta kundërshtuar në aspektin edhe material dhe ti bërë të njohur kësaj Gjykate

se lidhur me çështjen e Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrativ. ka vendimmarrje të ndryshme, i ka paraqitur si prova dy aktgjykime që janë aprovuar paditë e paditëseve në çështjen e njëjtë për punësim, siç është aktgjykimi Anr.412/23 me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit, si dhe aktgjykimin Anr.2699/22 dt.26.11.2024 të cilët paditës kanë pasur fatin e njëjtë si 9 paditësit në këtë çështje, duke u larguar nga puna për shkak të shfuqizimit të vendimit për emërim bazuar në konkursin e vitit 2012. I njëjti në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, e paditura ka bërë shkelje të rëndë të të drejtave të paditësve që burojnë nga marrëdhënia e punës, e që janë nënshtruar procedurave ligjore që nga testimet me shkrim, të gjuhëve, intervistës me gojë dhe nxjerrjes së vendimeve për emërimin e tyre në misione. Shërbimi diplomatik ka dy kategori të anëtarëve të shërbimit që emërohen në shërbim 1. Anëtarët e shërbimit diplomatik – emërim sipas çelësit që shkojnë direkt pa asnjë procedurë publike (në këtë sferë hyjnë shefat e misioneve) 2.Procedura e emërimit të këtyre anëtarëve përmes procedurës së rekrutimit që ka ndodhur si në rastin konkret duke i lëshuar në fund vendimin për emërim. Pra, e paditura ka dështuar që të vlerësoj drejtë se nuk është akt emërim ai që i jep statusin e NC të SHP por në bazë të Rregullores 02/2009 SHJ është në kompetencë të Ministrisë të Punëve të Jashtme të nxjerr vendim për emërim dhe jo akt emërim siç ka konstatuar gabimisht e paditura. Sa i përket vendimeve të MPJ-së, këto vendime janë shfuqizuar në mënyrë të paligjshme për shkak se në bazë të LPPA-së neni 58 par.2 përcaktohet se një vendim i paligjshëm që është nxjerr në dobi të palëve mund të shfuqizohet jo më larg se 30 ditë nga dita e njoftimit, por jo më gjatë se 5 vite nga dita e nxjerrjes së tij, e që në rastin konkret të gjitha vendimet për shfuqizimin e këtyre të përshkuara si në pikën 2 të petitumit të padisë të cilat janë nxjerr për shfuqizimin e vendimeve të lartcekura kanë më shumë se 5 vite, gjegjësisht nga 7-10 vite që janë nxjerr në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 të LPPA-së. Paligjshmëria në aspektin material konsiston edhe në faktin se Ministria me rastin e shfuqizimit të vendimeve fillestare të paditësve përveç tyre shfuqizon edhe vendimet e nxjerra nga Sekretari i Përgjithshëm, të cilat janë nxjerr për sistemim të paditësve brenda MPJD si dhe shfuqizon edhe akt emërime të paditësve, e që është shkelje ligjore e Ministrisë së Punëve të Jashtme në kompetencat e Sekretarit i cili si ZKA është i vetmi organ kompetent që menaxhon me nëpunësit dhe shërbyesit. Po ashtu thekson se, në vendimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme gjejmë dispozitat mbi bazën e cilave ka marrë vendimet për largimin e paditësve nga puna të cilat nuk janë të bazuara në asnjë fakt dhe provë me të cilat mund të konstatonte se paditësit kanë humbur statusin e anëtarëve të Shërbimit Diplomantik-nëpunësve civil siç përcakton dispozita e nenit 25 LPSHJ që përcakton 4 raste kur anëtari i SHJ humb statusin e shërbyesit, kur largohet vullnetarisht, kur humb zotësinë e veprimit, kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë apo kur kryen shkelje të rëndë të përcaktuara me rregullore për të cilat ndaj tij shqiptohet masa e largimit nga puna, e që asnjëra nga këto kritere nuk janë zbatuar në rastin e paditësve dhe nuk përkon me humbjen e tyre të statusit të SHD-NC. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të nxjerr vendim meritore me të cilin aprovohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësve dhe anulohen vendimet e të paditurës A.nr.365/22 dt.10.06.2022 si dhe vendimet e MPJ numër 152/22 dt.15.03.2022, 149/22 dt.16.03.2022, 144/22 dt.15.03.2022, 148/22 dt.15.03.2022, 153/22 dt.15.03.2022, 150/22 dt.16.03.2022, 146/22 dt.15.03.2022 dhe 145/22 dt.15.03.2022 dhe të mbeten në fuqi vendimet sipas pikës 3 të petitumit të padisë me të cilat paditësit kthehen në pozitë e tyre sipas vendimeve, gjegjësisht akt emërimeve si në pikën 3 të petitumit të kësaj padie nga pika 1-9 si dhe të obligohet MPJ që të njëjtit ti kthej në vendin e punës. Duke pasur parasysh që kemi ekspertizën me të cilën

janë përlogaritur pagat dhe beneficinet për paditësit nga marrëdhënia e punës i njëjti e ka precizuar petitumin e padisë në pikën 3 të saj sa i përket lartësisë së kompensimit material dhe atë mbi bazën e të dhënave si në tabelën 2 faqe 35 duke filluar nga paditësi L. R. për të cilin MPJD obligohet të kompensoj lartësinë prej 14.615,05 Euro për periudhën deri 15.04.2024 për shkak të arritjes së pensionimit, për M. F. nga dt.31.03.2022 deri në përpilimin e ekspertizës 25.552,37 Euro, për B. H. nga dt.31.03.2022 deri në përpilimin e ekspertizës vlerë prej 17.921,17 euro, për Rr. M. nga dt.16.03.2022 deri në përpilimin e ekspertizës vlerë 13.884,19 Euro, për B. B. nga dt.16.03.2022 deri në përpilimin e ekspertizës vlerë 18.369,07 Euro, për A.D. nga dt.16.03.2022 deri në përpilimin e ekspertizës vlerë 17.547,64 Euro, për Sh. B. nga dt.16.03.2022 deri në përpilimin e ekspertizës vlerë 17.547,64 Euro, për E. B. nga dt.16.03.2022 deri në përpilimin e ekspertizës vlerë 8.541,13 Euro si dhe për B. C. nga dt.16.03.2022 deri në përpilimin e ekspertizës vlerë 4.845,82 Euro, kjo shume të paguhet nga MPJD e cila përfshin pagat neto dhe kamatën 8% sipas ekspertizës. I njëjti në fjalën përfundimtare ka kërkuar që për L. R. që tani ka dal në pension të bëjë kompensimin material në vlerë prej 15.005,74 Euro për pozitën e zyrtarit të lartë në Dep.Sherbimeve Konsulore sipas Akt emërimit AE08/2021 dt.19.02.2021, për M. F. pozitën e Zyrtarit të Lartë në Dep.Sherbimeve Konsulore sipas Akt emërimit AE.nr.11/2021 dt.19.02.2021 dhe kompensimin në mënyrë retroaktive vlerën prej 21.643,85 Euro, për B. H.ta kthej në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Privilegje dhe Imunitete në Dep.e protokollit sipas Akt emërimit AE.nr.05/2021 dt.19.02.2021 kompensimin material në vlerë prej 18.944,88Euro, për paditësin Rr. M. ta kthej në pozitën e Zyrtarit për çështje sigurie në divizionin IT sipas Akt emërimit AE.nr.18/2021 dt.19.02.2021 dhe kompensimin material në vlerë prej 14.799,26Euro, për paditësin B. B. të kthej në Zyrtarin e Lartë të Pasurisë për Financa të Përgjithshme sipas vendimit nr.136/2020 dt.01.01.2020 si dhe kompensimin material vlerë 19.099,08 Euro, për paditësen Sh. B. ta kthej në pozitën Zyrtare e Lartë në Parlamentin Evropian dhe Evropë Lindore Dep.Evropë dhe BE Akt emërimi AE.29/2021 dt.15.06.2021 si dhe kompensimin material vlerë prej 18.816,25 Euro, për paditësin A. D. zyrtar i larte për politika të OSBE për politika NATO dhe OSBE vendimit 111/2020 dt.01.09.2021 si dhe kompensimin material vlerë prej 18.816,25 Euro, për paditësin E. B. ta kthej në pozitën Zyrtar i Lartë për politika të sigurisë në Departamentin Nato dhe Politika të Sigurisë sipas vendimit 15/2021 dt.01.02.2021 si dhe kompensimit material në vlerë prej 8.541,13 Euro si dhe paditësin B. C.ta kthej në pozitën Zyrtar i Lartë për KE – Evropën Jugore Departamenti për Evropë dhe BE sipas vendimit 116/2020 dt.01.09.2020 si dhe kompensimin material në vlerë prej 4.896,60 Euro, kjo shume të paguhet nga MPJD e cila përfshin pagat neto dhe kamatën 8% sipas ekspertizës.

I padituri, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në përgjigjen në padi të datës 02.10.2024 i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë padinë e paditësve si të pa bazuar, ashtu që të vërtetojë Vendimin A.nr.365/2022 të KPMSHCK-së, për arsye se pretendimet e paditësve janë të pabazuara, sepse nuk janë të argumentueshme me prova materiale dhe vendimi kontestues është vendim i drejtë i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe është nxjerr si rezultat i konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe juridike. I njëjti në seancat e shqyrtimit gjyqësor përmes të autorizuarit të tij ka deklaruar se, në këtë procedurë administrative si palë ankuese ka qenë edhe një ankues që është ritheksuar në vendimin e kontestuar e i njëjti këtë vendim e ka kontestuar në procedura gjyqësore në padi të ndarë në raport me këta paditës, e për rrjedhojë gjykata përmes Aktgjykimit me numër A.nr. 1759/2022 ka refuzuar në tërësi

kërkesëpadinë e paditësit duke e vërtetuar në tërësi si të ligjshëm vendimin e kontestuar nga ky paditës. Po ashtu, thekson se paditësi te cilit iu referova edhe me herët e ka pasur edhe një procedure tjetër administrative në KPMSHSK po ashtu edhe pranë gjykatës e ku Këshilli ka nxerrur vendimin e njëjtë sikurse vendimi i kontestuar përmes kërkesëpadiës, e i cili vendim është vërtetuar plotësisht nga kjo gjykatë si dhe nga Gjykata e Apelit e të cilat Aktgjykime janë të bashkangjitura përgjigjes në padi të dorëzuar në gjykatë në kopje të mjaftueshme. Duke u bazuar në Vendimin e kontestuar po ashtu edhe aktgjykimeve te kësaj gjykate dhe të Apelit konsideron qe vendimi i kontestuar përmes padisë është komplet i ligjshëm dhe i drejtë. Shton se, gjykatës i ka dorëzuar prova të mjaftueshme, gjegjësisht Aktgjykimet e kësaj gjykate dhe asaj të Apelit, ndërsa i ka dorëzuar edhe një provë tjetër Aktgjykimin ARJ.nr.138/2024 dt.21.01.2025 përmes të cilës është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe njëkohësisht është refuzuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit. Sa i përket ekspertizës konsideron se e njëjta nuk ka mbështetje ligjore bazuar në vendimin e kontestuar me padi, praktikën deri në gjykatën Supreme. Konstaton që, sipas provave materiale të lëndës praktikës nga gjykata e Apelit dhe ajo Supreme konsideron se kërkesëpadija është e pabazuar dhe kërkon që e njëjta të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i kontestuar me padi është i drejte dhe i ligjshëm dhe kërkon që i njëjti të mbetet në fuqi.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 10.02.2025, ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimi për shpalljen e konkursit numër 140/11 dt.21.07.2011, konkursi për drejtues dhe nëpunës tjerë të Misionit Konsullor nga MPJ i datës 22.07.2011, Lista e kandidatëve aplikues Gusht 2011, Vendim i datës 13.11.2012 nr.ref.1060/12, Vendimi i datës 15.07.2019 nr.339/2019, Vendimi nr.133/2020 dt.01.09.2020, Akt emërimi në emër të L. R. AE.nr.08/2021 dt.19.02.2021, Vendimi i datës 15.03.2022 nr.ref.152/2022, Ankesa dt.14.04.2022 nga L. R. drejtuar KPMSHCK numër 2087, Vendimi numër ref.242/13 dt.10.05.2013, Vendim nga MPJD 27.02.2020, Vendim për sistemim e përhershëm dt.01.09.2020 nr.122/2020, Akt emërim në emër të M. F. AE.nr.11/2021 dt.19.02.2021, Vendim numër 149/2022 dt.15.03.2022, Ankesa drejtuar KPMSHCK e datës 14.04.2022, Vendimi i datës 08.04.2014 nr.ref.193/14, Vendimi i datës 27.07.2020 nr.ref.445/2020, Vendimi nr.124/2020 dt.01.09.2020, Akt emërimi në emër të B. H. AE.nr.05/2021 dt.19.02.2021, Vendimi me numër nr.ref.147/2022 dt.15.03.2022, Ankesa drejtuar KPMSHCK dt.14.04.2022, komunikime elektronike B. H. dhe zyra personelit MPJ dt.06.06.2011, komunikime elektronike 04.06.2011, komunikime elektronike për testin e gjuhës angleze, komunikime elektronike për testin për gjuhë gjermane, komunikime elektronike për njoftim për gjuhë kroate për kandidatët të cilët kanë aplikuar sipas konkursit, Vendimi i datës 26.07.2012 nr.ref.725/2012, Dekret në emër të Rr. M. me nr.DED-016-2012 dt.31.07.2012, Vendimi datës 10.07.2020 nr.304/2020, Vendim për sistemim të përhershëm nr.134/2020 01.09.2020, akt emërim në emër të Rrahim AE.18/2021 19.02.2021, Vendim nr.ref.144/2022 dt.15.03.2022, Ankesa nga R. M. dt.14.04.2022, Komunikime elektronike ftese për pjesëmarrje për testim dt.27.01.2012, 10.06.2012, Vendim dt.10.07.2020 nr.303/2020, Vendim dt.13.11.2012 nr.ref.1061/12, Vendim për sistemim te përhershëm dt.01.09.2020 nr.136/2020, Vendim nr.ref.148/2022 dt.15.03.2022, vendim për sistemim te përhershëm nr.111/2020 dt.01.09.2020, Ankese nga B. B. dt.14.04.2022, ftese për pjesëmarrje ne testim për kandidatët dt.08.02.2012, 10-11.02.2012, vendim dt.19.02.2014 ref.095/14, Vendim dt.10.07.2020

nr.332/2020, Vendim 114/2020 dt.01.09.2020, akt emërim ne emër te Sh. B. AE.nr.29/2021 dt.15.06.2021, Vendim dt.15.03.2022 nr.ref.153/2022, ankese nga Sh. B. dt.14.04.2022, Komunikime elektronik nga zyra personelit njoftimi për interviste, komunikime elektronike dt.17.03.2022, Komunikime elektronike 17.03.2022 19:31 A. H., komunikime elektronike dt.06.02.2012 testi për gjuhë angleze, Komunikime elektronike njoftim për gjuhë angleze 01.02.2012, Komunikime elektronike njoftimin per Sh. B. nga Uliks Emra, Komunikime elektronike A. K. dt.21.02.2014, komunikime elektronike 20.02.2014, vendim nr.ref.1064/12 13.11.2012 në emër të A. D., Vendim dt.27.03.2020 nr.ref.102/2020, akt emërim në emër të A. D. AE.nr.01/2021 dt.19.02.2021, Vendim dt.15.03.2022 nr.ref.150/2022, Ankese nga A. D.dt.14.04.2022, komunikime elektronike dt.31.05.2021, 06.02.2012 nga A. D., Komunikime elektronike 31.01.2012, 03.02.2012, Komunikime elektronike ZP MPJ 28.01.2012, Vendim dt.28.05.2014 ref.421/14, Vendim për sistemim te përhershëm ref.15/21 dt.01.02.2021, Vendim dt.15.03.2022 nr.ref.146/2022, Ankese nga E. B. dt.14.04.2022, Komunikime elektronike ZP MPJ 02.06.2012 për njoftimin e testimi me shkrim, Komunikime elektronike 31.01.2012, Vendim dt.13.11.2012 nr.ref.1059/12, Vendim dt.10.07.2020, nr.321/2020, Vendim për sistemim të përhershëm nr.116/2020 dt.01.09.2020, Vendim dt.15.03.2022 nr.ref.145/2022, Ankese nga B. C. dt.14.04.2022, Komunikime elektronike 19.12.2012, 28.01.2012, 31.01.2012, 03.02.2012, 06.02.2012, 07.02.2012, Kërkese për qasje ne dokumente zyrtare dt.21.03.2022 nga av.H. S., komunikime elektronike “Njoftim për afat shtese”, Vendim për bashkim te lendeve nr.21/2022 dt.05.05.2022, Procesverbal mbi seancën dëgjimore A.nr.365/2022 dt.18.05.2022, Procesverbal mbi seancën dëgjimore A.nr.365/2022 dt.20.05.2022, Vendim për vazhdimin e afatit, Vendim A.nr.365/2022 dt.10.06.2022, Mendim mos pajtues A.nr.365/2022 dt.10.06.2022, Vendim nr.47/2022 dt.29.04.2022, Plani i vizitave te monitorimit 2555/22 dt.29.04.2022, Shpallje e shprehjes se interesit nr.ref.08/2022 dt.08.02.2022, Liste distribuomi dt.03.11.2021, Raporti final i auditimit – menaxhimi i burimeve njerëzore tetor 2021, Vendimi për emërimin e paditësit L. R. këshilltar, Vendimi për shtyrjen e ekzekutimit te vendimit 198/2020, Vendimi nga MPJ ref.773/18 dt.10.09.2018, Vendimi 210/2017 dt.20.07.2017, Vendimi nr.34/2018 dt.18.01.2018, Vendimi 470/19 12.12.2019, Vendimi nr.54/15 dt.19.06.2015, Vendimi ref.183/2017 dt.12.06.2017, Vendimi 259/2020 dt.30.06.2020, Vendimi nr.244/2014 dt.25.04.2014 A. D., Vendimi nr.561/2018 dt.13.07.2018 A. D., Vendimi nr.345/2019 dt.16.07.2019 A. D., vendimi 131/19 dt.09.09.2019, Vendim për ngritje ne grade dt.12.08.2016 nr.346/16, Vendimi ref.996/2020 dt.10.12.2020, Vendimi 042/15 dt.30.12.2015, Vendimi për korgjimin i vendimit 890/18 ref.894/18 dt.06.11.2018, Aktgjykimi Anr.1346/2021 dt.05.04.2023, Aktgjykimi AA.nr.398/2023 dt.11.07.2024, Aktgjykimi Anr.2699/22 dt.26.11.2024, Aktgjykimi Anr.412/2023 17.08.2023, Aktgjykimi ARJ 138/2024 dt.21.01.2025 dhe Ekspertiza financiare nga V. S. dt.15.11.2024, Aktgjykimi Gjykatës Supreme Arj.nr.115/2022 dt.09.11.2022, Aktvendimi Anr.1687/22 dt.05.07.2022, Ankesa dt.29.07.2022, Aktvendimi AAnr.597/22, Kërkesa për rishqyrtim te jashtë zakonshëm te vendimit gjyqësor 10.10.2022, Aktvendim Anr.1687/22 dt.22.03.2023.

Gjykata në këtë çështje të konfliktit administrativ kishte referim nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe u bazuar në provat e administruara, padinë, përgjigjen në padi si dhe deklarimit të palëve ndërgjyqëse, konstatoi se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me Aktvendimin A.nr.1687/2022, i datës 05.07.2022 është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të gjykuar në këtë çështje sipas padisë së paditësve. Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktvendimin AA.nr.597/2022, të datës 25.08.2022, ka refuzuar ankesën e paditësve si të pabazuar dhe ka vërtetuar Aktvendimin A.nr.1687/22. Paditësit kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit. Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.115/2022, me datën 09.11.2022 ka aprovuar ankesën e paditësve dhe ka prish Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.597/22 të datës 25.08.2022 dhe Aktvendimin A.nr.1687/2022, i datës 05.07.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative dhe lënda është kthyer gjykatës së shkallës së parë për gjykim të mëtejshëm, ndër të tjera në arsyetimin e vendimit Gjykata Supreme ka rekomanduar që gjykata e shkallës së parë me rastin e rivendosjes duhet të marrë parasysh aktvendimin e departamentit të përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë Divizioni Civil C.nr.3405/2022.

Me vendimin e datës 13.11.2012 me numër të referencës 1060/12 të nxjerr nga MPJ paditësi L. R. është emëruar anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, duke u caktuar grada konsullore – Konsull.

Me vendimin e datës 15.07.2019 me numër Nr.339/2019 L. R. me Gradën Këshilltar në Misionin Diplomatik në Sofje/Bullgari tërhiqet/kthehet nga Misioni, për nevojat e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Me vendimin e datës 01.09.2020 me numër 133/2020 të nxjerr nga MPJ – Sekretari i Përgjithshëm, L. R. sistemohet në pozitën Zyrtar i Lartë për Shërbime Konsullore-Divizionit për Shërbime Konsullore Departamentit për Çështje Konsullore në Ministrinë e punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësive në këtë pozitë e fillon me datën 01.09.2020.

Paditësi L. R. e ka marrë Akt emërimin me datën 19.02.2021 me numër AE Nr.08/2021 me titull të vendit të punës Zyrtar i Lartë për Shërbime Konsullore, ku marrëdhënia e punës në këtë pozitë fillon me dt.01.09.2020.

Me vendimin e datës 16.03.2022 me numër të protokollit 873 është shfuqizuar vendimi me numër reference 1060 i datës 13.11.2012 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe është shfuqizuar vendimi me numër 133/2020 i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm për Sistemimin e Përhershëm të L. R., si dhe Akt emërimi bazuar në këtë vendim.

I njëjti kundër këtij vendimi të datës 16.03.2022 me datën 14.04.2022, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me vendimin e datës 10.05.2013 me numër të referencës 242/13 paditësi Mitat Fejza është emëruar anëtarë i Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, duke u caktuar grada konsullore – Konsull.

Me vendimin e vitit 2020 (nuk shihet data) paditësi M. F. me Gradën Konsull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Paris, pas përfundimit të mandatit të tij tërhiqet/kthehet nga Misioni në MPJD.

Me vendimin e datës 01.09.2020 me numër 122/2020 të nxjerr nga MPJ – Sekretari i Përgjithshëm, M. F. sistemohet në pozitën Zyrtar i Lartë për Shërbime Konsullore-Divizionit për Shërbime Konsullore Departamentit për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësive në këtë pozitë e fillon me datën 01.09.2020.

Paditësi M. F. e ka marrë Akt emërimin me datën 19.02.2021 me numër AE Nr.11/2021 me titull të vendit të punës Zyrtar i Lartë për Shërbime Konsullore, ku marrëdhënia e punës në këtë pozitë fillon me dt.01.09.2020.

Me vendimin e datës 15.03.2022 me numër të protokollit 875 është shfuqizuar vendimi i datës 10.05.2013 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe është shfuqizuar vendimi me numër 122/2020 i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm për Sistemimin e Përhershëm të M. F., si dhe Akt emërimi nga ky vendim.

I njëjti kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me vendimin e datës 08.04.2014 me numër të referencës 193/14 paditësja B. H. është emëruar anëtarë i Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, duke ju caktuar grada konsullore – Konsull.

Me vendimin e datës 27.07.2020 me numër të referencës 445/2020 paditësja B. H. me Gradën Konsullore Konsull në Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës në Stuttgart për nevoja të punës në Ministri tërhiqet/kthehet nga Misioni në MPJD.

Me vendimin e datës 01.09.2020 me numër 124/2020 të nxjerr nga MPJ – Sekretari i Përgjithshëm, B. H. sistemohet në pozitën Zyrtare e Lartë për Privilegje dhe Imunitete – Departamenti i Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësive në këtë pozitë e fillon me datën 01.09.2020.

Paditësja B. H. e ka marrë Akt emërimin me datën 19.02.2021 me numër AE Nr.05/2021 me titull të vendit të punës Zyrtare E lartë për Privilegje dhe Imunitete, ku marrëdhënia e punës në këtë pozitë fillon me dt.01.09.2020.

Me vendimin e datës 15.03.2022 të protokolluar me datën 16.03.2022 është shfuqizuar vendimi i datës 08.04.2014 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe është shfuqizuar vendimi me numër 124/2020 i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm për Sistemimin e Përhershëm të B.H., si dhe Akt emërimi nga ky vendim.

E njëjta kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me vendimin e datës 26.07.2012 me numër të referencës 725/2012 paditësi Rr. M. është emëruar anëtarë i Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, duke ju caktuar grada diplomatike Ministër – Këshilltar.

Me vendimin e datës 10.07.2020 me numër të referencës 304/2020 paditësi Rr. M. me Gradën Diplomate Ministër Këshilltar në Ambasadën e Kosovës në Bern, pas përfundimit të mandatit të tij tërhiqet/kthehet nga Misioni në MPJD.

Me vendimin e datës 01.09.2020 me numër 134/2020 të nxjerr nga MPJ – Sekretari i Përgjithshëm, Rr. M. sistemohet në pozitën Zyrtar Për Çështje Sigurie – Divizioni për IT dhe Shërbime Logjistike në MPJD dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësive në këtë pozitë e fillon me datën 01.09.2020.

Paditësi Rr. M. e ka marrë Akt emërimin me datën 19.02.2021 me numër AE Nr.18/2021 me titull të vendit të punës Zyrtar për Çështje Sigurie, ku marrëdhënia e punës në këtë pozitë fillon me dt.01.09.2020.

Me vendimin e datës 15.03.2022 të protokolluar me datën 16.03.2022 është shfuqizuar vendimi i datës 26.07.2012 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe është shfuqizuar vendimi me numër 134/2020 i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm për Sistemimin e Përhershëm të Rr. M., si dhe Akt emërimi nga ky vendim.

I njëjti kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me vendimin e datës 13.11.2012 me numër të referencës 1061/12 paditësi B. B. është emëruar anëtarë i Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, duke ju caktuar grada diplomatike Këshilltar.

Me vendimin e datës 10.07.2020 me numër të referencës 303/2020 paditësi B. B. tërhiqet/kthehet nga Misioni në MPJD.

Me vendimin e datës 01.09.2020 me numër 136/2020 të nxjerr nga MPJ – Sekretari i Përgjithshëm, B. B. sistemohet në pozitën Zyrtar i Lartë i Pasurisë – Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësive në këtë pozitë e fillon me datën 01.09.2020.

Me vendimin e datës 15.03.2022 të protokolluar me datën 16.03.2022 është shfuqizuar vendimi i datës 13.11.2012 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe është shfuqizuar vendimi me numër 136/2020 i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm për Sistemimin e B. B. në pozitën Zyrtar i Lartë i Pasurisë.

I njëjti kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me vendimin e datës 19.02.2014 me numër të referencës 095/14 paditësja Sh. B. është emëruar anëtare e Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, duke ju caktuar grada diplomatike Sekretare e Parë.

Me vendimin e datës 10.07.2020 me numër të referencës 332/2020 paditësja Sh. B. tërhiqet/kthehet nga Misioni në MPJD.

Me vendimin e datës 01.09.2020 me numër 114/2020 të nxjerr nga MPJ – Sekretari i Përgjithshëm, Sh. B. sistemohet në pozitën Zyrtare e Lartë për Parlamentin Evropian dhe Evropë Lindore – Departamenti për Evropë dhe BE në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësive në këtë pozitë e fillon me datën 01.09.2020.

Paditësja Sh. B.e ka marrë Akt emërimin me datën 15.06.2021 me numër AE Nr.29/2021 me titull të vendit të punës Zyrtare E Lartë për Parlamentin Evropian dhe Evropë Lindore, ku marrëdhënia e punës në këtë pozitë fillon me dt.01.09.2020.

Me vendimin e datës 15.03.2022 të protokolluar me datën 16.03.2022 është shfuqizuar vendimi i datës 19.02.2014 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe është shfuqizuar vendimi me numër 114/2020 i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm për Sistemimin e Përhershëm të Sh. B., si dhe Akt emërimi nga ky vendim.

E njëjta kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me vendimin me numër të referencës 1064/12 paditësi A.D. është emëruar anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, duke ju caktuar grada diplomatike Ministër Këshilltar.

Me vendimin e datës 27.03.2020 me numër të referencës 102/2020 paditësi A. D. tërhiqet/kthehet nga Misioni në MPJD.

Paditësi A. D. e ka marrë Akt emërimin me datën 19.02.2021 me numër AE Nr.01/2021 me titull të vendit të punës Zyrtar i Lartë për Politikën e OSBE-së, ku marrëdhënia e punës në këtë pozitë fillon me dt.01.09.2020.

Me vendimin e datës 15.03.2022 të protokolluar me datën 16.03.2022 është shfuqizuar vendimi i datës 13.11.2012 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe është shfuqizuar vendimi me numër 111/2020 i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm për Sistemimin e Përhershëm të A. D., si dhe Akt emërimi nga ky vendim.

I njëjta kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me vendimin e datës 28.05.2014 me numër të referencës 421/14 paditësi E. B. është emëruar anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, duke ju caktuar grada diplomatike Këshilltar.

Me vendimin e datës 31.02.2021 me numër të referencës 15/2021 paditësi E. B. sistemohet në pozitën Zyrtar i Lartë për Politika të Sigurisë, Departamenti për Nato dhe Politika të Sigurisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësi në këtë pozitë e fillon me datën 01.09.2020.

Me vendimin e datës 15.03.2022 të protokolluar me datën 16.03.2022 është shfuqizuar vendimi i datës 28.05.2014 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe është shfuqizuar vendimi me numër 15/2021 i datës 01.02.2021 i Sekretarit të Përgjithshëm për Sistemimin e Përhershëm të E. B. në pozitën Zyrtar i Lartë për Politika të Sigurisë, Departamenti për Nato dhe Politika të Sigurisë.

I njëjti kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me vendimin e datës 13.11.2012 me numër të referencës 1059/12 paditësi B. C. është emëruar anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, duke ju caktuar grada diplomatike Këshilltar.

Me vendimin e datës 01.09.2020 me numër të referencës 116/20 paditësi B. C. sistemohet në pozitën Zyrtar i Lartë për Këshillin Evropian/Evropën Jugore – Departamenti për Evropë dhe BE në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësi në këtë pozitë e fillon me datën 01.09.2020.

Me vendimin e datës 15.03.2022 të protokolluar me datën 16.03.2022 është shfuqizuar vendimi i datës 13.11.2012 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga ky emërim, si dhe është shfuqizuar vendimi me numër 116/2020 i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm për Sistemimin e Përhershëm të B. C. në pozitën Zyrtar i Lartë për Këshillin Evropian/Evropën Jugore – Departamenti për Evropë dhe BE.

I njëjti kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me vendimin me numër 21/2022 të datës 05.05.2022 të lëshuar nga i padituri Këshilli i pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të gjitha këto ankesa të paditësve janë bashkuar në një ankesë me numër A.nr.365/2022 tek ankuesi L. R..

Me vendimin kontestues të të paditurit KPMSHCK me numër A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022, i Padituri KPMSHCK është shpallur Jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga këtu paditësit.

Paditësit e pakënaqur me këtë vendim, kanë parashtruar padi në këtë gjykatë me datën 05.07.2022 duke kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, gjykata iu referua dispozitave të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe gjeti se në këtë rast akti i kontestuar me padi përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkëljet thelbësore të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe atë nenin 48 paragrafi 1 dhe 2 në të cilin është përcaktuar se:” 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Madje dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin, ngase në dispozitivin e vendimit i padituri KPMSHCK shpallet jo kompetent për të trajtuar ankesën e paditësve, ndërsa në arsyetimin e tij ka theksuar se: ”në kuptim të provueshmërisë së ankesës kolegji iu referua dispozitave të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ligj ky i aplikueshëm, përkatësisht nenin 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se:” *Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi*” si dhe nenit 8 të Ligjit nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik në të cilën parashihet se:” *8.1 Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovës*” dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji me shumicë votash konstaton se përveç të emëruarve politikë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë edhe personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo të angazhuar në shërbim të jashtëm, kanë statusin e nëpunësit civil dhe se pranimi i tyre në shërbim të jashtëm duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbim të jashtëm dhe legjislacionit të aplikueshëm për shërbimin civil, andaj mbi këtë bazë ligjore, si dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesit, këtu paditësit ishin emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e meqenëse me asnjë provë nuk vërtetohet se të njëjtat kanë themeluar marrëdhënie të punës në shërbimin civil përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit ashtu sic përcaktohej me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin përcaktohet se:” *Nëpunësit civil themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil...*” Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën

paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pra, nga një arsyetim i tillë shihet se i padituri në vendimin e kontestuar, vetë e ka pranuar faktin se pozita në të cilën janë emëruar paditësit në shërbimin e Jashtëm përbënë pozitë të nëpunësit civil, por meqë paditësit ishin emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimeve të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e meqenëse me asnjë provë nuk vërtetohet se të njëjtit kanë themeluar marrëdhënie të punës në shërbimin civil përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit, konstaton se KPMSHCK nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e paditësve.

Në këtë rast gjykata vlerëson se, shpallja jo kompetente e të paditurit për të vendosur sipas ankesës së paditësve, duke u referuar vetëm në çështjen e mungesës së aktit të emërimit të ankuesve, nuk është vlerësim i drejtë dhe i bazuar, sepse në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *”Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi“*, Është e pa kontestueshme që personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës, ashtu siç është e pakontestueshme se të punësuarit në shërbimin e jashtëm i nënshtrohen legjislacionit të aplikueshëm për shërbimin civil dhe legjislacionit të veçantë që rregullon shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës.

Gjykata konstaton se, çështja e statusit të të punësuarve në shërbimin e jashtëm ka qenë e përcaktuar me nenin 3 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe rrjedhimisht ashtu sikurse me ligjin e aplikueshëm në kohën e themelimit të marrëdhënies së punës të ankuesve, edhe me ligjin aktual, përcaktohet se nëpunësit e shërbimit të jashtëm diplomatik dhe konsullor, përjashtimisht të emëruarve politik, kanë statusin e nëpunësit civil dhe të njëjtit i nënshtrohen përveç këtij ligji edhe legjislacionit të veçantë.

Gjykata vlerëson se, çështja e kompetencës nuk duhet të lidhet vetëm me aktin formal të themelimit të marrëdhënies së punës, por me pozitën në të cilën paditësit janë emëruar dhe kanë ushtruar detyrën dhe në këtë kuptim gjykata vlerëson se i padituri është kompetent për vendosjen e ankesës së paditësve.

Bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës,, rezulton se Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme me datë 21.07.2011 kishte nxjerrë vendimin nr.140/11 për miratimin e shpalljes së konkursit për përfaqësues diplomatik dhe konsullor në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë vendim Ministria e Punëve të Jashtme me datë 22.07.2011 ka shpallur konkursin publik për drejtues dhe nëpunës tjerë të misionit konsullor dhe për anëtarë të misionit diplomatik, e në të cilin konkurs kishin aplikuar edhe këtu paditësit.

Gjykata gjen se, paditësit në ankesën drejtuar të paditurit KPMSHCK pretendojnë se i janë nënshtruar të gjitha procedurave të konkursit dhe vlerësojnë se vendimet e kundërshtuara me ankesë, gjegjësisht vendimet e lëshuara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me të cilat vendime janë shfuqizuar vendimet me emërimin e paditësve në shërbimin e jashtëm diplomatik dhe konsullor të Republikës së Kosovës, janë nxjerr përmes shkeljeve të dispozitave ligjore procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjen faktike dhe shkeljeve të ligjit material.

Gjykata konstaton se, të gjithë paditësit në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës janë nënshtruar konkursit publik të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme si autoritet përgjegjës. Kjo nuk është kontestuese as nga vetë organi i punësimit, mirëpo kontestuese është se nuk ka listë përfundimtare të rezultateve të kandidatëve.

Sipas nenit 58 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është përcaktuar se:” 1. *Anulimi në rastin e paraparë nga neni 55 i këtij Ligji si dhe shfuqizimi në rastin e paraparë nga paragrafi 1 i nenit 57 të këtij Ligji, mund të bëhet në çdo kohë. 2. Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur organi publik i përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 53 të këtij Ligji, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se pesë (5) vjet nga njoftimi i aktit administrativ”.* Gjykata referuar nenit 58 të LPPA-së ku përfaqësuesi i paditësve është thirr dhe është deklaruar sa i përket veprimeve të Ministrisë së Punë të Jashtme me rastin e marrjes së vendimeve në raport me paditësit nuk është lëshuar në vlerësim e veprimeve të organit punëdhënës. Po ashtu edhe sa i përket kërkesës së paditësve për detyrimin lidhur me kompensimin e pagave dhe beneficioneve nga marrëdhëia e punës për faktin se në kuptim të nenit 9 të LKA-së ka vlerësuar vetëm ligjshmërinë e vendimit përfundimtar administrativ, organi administrativ MPJD nuk është palë e paditur me padi dhe se nuk është palë në këtë procedurë të konfliktit administrativ.

Andaj, për gjykatën është e paqartë dhe nuk përbën arsyetim dhe konstatim të mjaftueshëm për shpalljen Jo kompetente të të paditurit KPMSHCK me vendimin kontestues, i cili ka vendosur për ankesën e paditësve vetëm duke iu referuar çështjes së mungesës së akt emërimit. Kjo për gjykatën nuk është vlerësim i drejtë dhe i bazuar në ligjet e lartcekura. Gjykata vlerëson se, çështja e kompetencës së Këshillit në rrethanat e rastit konkret nuk duhet të lidhet vetëm në aktin formal të themelimit të marrëdhënies së punës, por në pozitën në të cilën paditësit janë emëruar dhe kanë ushtruar detyrën.

Andaj, Gjykata nuk mund të pranoj si të drejtë vendimin e të paditurit dhe të njëjtin e ka anuluar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurin që të vlerësoj gjendjen faktike mbi bazën e provave dhe të referoj pretendimet e këtu paditësve, pasi që nga vendimi i atakuar me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe në bazë nenit 132 të LPPA-së referuar provave në shkresat e lëndës të trajtojë ankesën e paditësve të datës 14.04.2022 me numër A.nr.365/2022,

,veçanërisht zbatimin e plotë të Parimit të pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme si dhe Parimin e administratës së hapur, të përcaktuar në nenin 7, respektivisht nenin 8 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj, jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të aktgjykimit.

Gjykata kishte parasysh edhe deklarin e të paditurit si në përgjigje në padi dhe deklarimeve në seancë por gjykata ka vlerësuar se pretendimet e të paditurit, janë të pa bazuara dhe në kundërshtim me gjendjen faktike.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale, gjykata vendosi konform nenit 64 të LKA-së.

Andaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5,6, 38 si dhe nenit 43, 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 1687/2022 data 10.02.2025

G j y q t a r j a
Valbona Gjonbalaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.